



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive
 - * Aktivitete tjera

Korrik 2017

Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

Palët dhe përfaqësimi i tyre në procedurë

Me 05 korrik 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë: “Palët dhe përfaqësimi i tyre në procedurë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve për zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me palët dhe përfaqësimin e tyre në procedurë.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me palët, zotësinë për të qenë palë në procedure si dhe përfaqësuesit e palës (përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i personit juridik dhe përfaqësuesi me prokurë). Në pjesën e dytë u trajtua pozita e përfaqësuesit të përkohshëm dhe legjitimiteti i palëve në procedurë.

Gjithashtu ky trajnim u fokusua në analizën e praktikës gjyqësore lidhur me procedurën, rolin, të drejtat dhe detyrat e palëve në një proces gjyqësor civil dhe përfaqësimin e tyre.

Në trajnim u konstatua se praktika gjyqësore shpeshherë nxjerrë probleme dhe dilema se kush

mund ta ketë cilësinë e palës në procedurë, si dhe kush mund të jetë përfaqësues i palës i cili do të mbronte interesat e tij para gjykatës kompetente. U theksua se paqartësi paraqiten edhe lidhur me legjitimitetin e palëve në procedurë përkatësisht në kujdesin e gjykatës që paditësi dhe i padituri të jenë të legjitimuar si palë në një proces.

Trajnimi gjithashtu kishte për qëllim të ofroj edhe përgjigje në pyetjet dhe dilemat se kush mund të jetë palë në një proces civil? çka kuptojmë me zotësinë për të qenë palë e çka me zotësinë procedurale dhe kur fitohen ato? çka është përfaqësimi në një proces dhe sa lloje të përfaqësimit kemi? cilat janë të drejtat dhe detyrat e palëve ndërgjyqëse në proces? çka kuptojmë me legjitimitetin e palëve? cili është roli i gjykatës në legjitimitetin e palëve? Si dhe çka kuptojmë me legjitimitetin aktiv e çka me atë pasiv?

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e divizioneve civile nga Gjykata e Apelit, dhe gjykatat themelore si dhe zyrtarë ligjor.



Trafikimi me njerëz dhe kontrabandimi me migrantë

Më 06-07 korrik 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin dy ditorë me temë “Trafikimi me njerëz dhe kontrabandimi me migrant”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me legjislacionin vendor dhe kornizën ligjore ndërkombëtare në luftën kundër veprave penale të trafikimit me njerëz si dhe kontrabandimit me migrantë.

Në fokus të këtij sesioni trajnues ishte analizimi i hollësishëm i legjislacionit vendor dhe akteve ndërkombëtare që sanksionojnë dhe rregullojnë aspekte të ndryshme që ndërlidhen me elementet e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të trafikimit, parandalimi dhe mënyra më e mirë e luftimit të të gjitha formave të trafikimit me njerëz, si dhe rehabilitimi dhe ri integrimi i viktimave të trafikuar.

Në veçanti u diskutua për mënyrat adekuate të bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse në vend për luftimin dhe parandalimin e trafikimit me njerëz si dhe dallimet dhe ngjashmëritë në mes trafikimit dhe kontrabandimit me migrantë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe gjyqtarë e prokurorë të nivelit themelor.



Krimi i organizuar, trafikimi i drogës dhe rastet trans-nacionale- ngritja e aktakuzave

Më 19-20 korrik 2017, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit të BE-së "Fuqizimi i efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë", ka realizuar trajnimin me temë "Krimi i organizuar, trafikimi i drogës dhe rastet trans-nacionale-ngritja e aktakuzave".

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me elementet kyçe të veprave penale në lidhje me krimin e organizuar, mjeteve hetuese të cilat përdoren për të zbuluar këto vepra penale, personat të cilët duhet akuzuar, si dhe për masat hetuese që duhet të ndërmerren.

Gjatë dy ditëve të këtij sesiioni trajnues në fokus ishte analizimi një rasti real praktik, ku në këtë vepër penale janë të përfshirë qytetarë kosovar dhe të huaj. Rasti kishte të bëjë me një skemë të importimit të ilaçeve me shmangie të taksës së importit të cilat janë duke u importuar në Kosovë.

Përfitues në këtë trajnim ishin prokurorë nga Prokuroria Speciale, bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga Prokurorët e Prokurorisë Speciale si dhe Zyrtarë nga Policia e Kosovës.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

Aktivitetet e realizuara në PTF- korrik 2017

Akademia e Drejtësisë, me qëllim të përmbushjes së programit trajnues, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar prokurorët e sapoemëruar të shtetit.

Në trajnimin teorik, janë realizuar dy (2) sesione nga nën-moduli “Ngritja e shkathtësive sociale të prokurorëve”, ku janë trajtuar këto çështje: komunikimi, interaksioni social dhe ngritja e shkathtësive sociale predispozitë e avancimit të performancës profesionale.

Po ashtu janë realizuar dy (2) sesione trajnuese nga nën-moduli “E drejta e BE-së”, në kuadër të të cilave janë trajtuar: Institucionet e Bashkimit Evropian dhe procesi i vendimmarrjes, si dhe burimet e së drejtës së Bashkimit Evropian.

Në kuadër të trajnimit praktikë, prokurorët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në prokuroritë përkatëse, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre.



Aktivitetet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Kursi Hyrës – Moduli 2

Me 11-13 korrik 2017, Akademia e Drejtësisë ka realizuar pjesën e dytë të trajnimit për pjesëtarët e sapoemëruar të administratës së gjykatave dhe prokurorive “Kursi Hyrës – Moduli 2”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të njoftohen, me zhvillimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe ndryshimet legjislative që janë bërë pas reformës më të re në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës. Po ashtu të kuptojnë drejtë dispozitat kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi lidhur me sistemin gjyqësor dhe prokurorial, të njohin strukturën aktuale dhe kompetencat e gjykatave dhe prokurorive në Republikën e Kosovës si dhe të stafit administrativ dhe kategoritë e tij.

Gjatë tri ditë të trajnimit janë elaboruar tema të ndryshme si: hyrje në punën e gjykatave dhe prokurorive, struktura, organogramet, kategoritë e stafit administrativ dhe të drejtat e detyrimit e tyre; komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm dhe puna në ekip; rregullat dhe rregulloret kryesore për menaxhimin e rrjedhës së lëndëve; prezantimi i llojeve të regjistrave dhe dokumenteve të mirëmbajtura nga stafi administrativ, rregullat dhe mostrat; specifikat e punës në çështjet penale dhe çështjet administrative, llojet e rasteve, aktet gjyqësore dhe seancat gjyqësore; si dhe procedurat gjyqësore dhe detyrat përkatëse të personelit administrativ, dërgimi i thirrjeve dhe afatet.

Një pjesë e trajnimit u realizua nëpërmjet punës në grupe, ku pjesëmarrësit përmes detyrave të caktuara patën mundësinë të shtjellojnë çështje të ndryshme, si dhe njëkohësisht të shkëmbejnë eksperiencat e tyre nga puna praktike. Përfitues të këtij trajnimi ishin pjesëtarët e sapoemëruar të administratës së gjykatave dhe prokurorive të pozitive të ndryshme si: zyrtar ligjor, zyrtar për buxhet dhe financa, referent, etj.



Aktivitetet tjera

Këshilli për Bashkëpunim Rajonal pret në takim Institucionet e Trajnimit Gjyqësor të vendeve të Ballkanit Perëndimor

Me 6 korrik 2017, përfaqësues të Akademisë së Drejtësisë kanë marrë pjesë në takim të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor, i organizuar nga Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, që u mbajt në Bruksel.

Në takim u diskutua bashkëpunimi i ardhshëm në mes të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të vendeve të Ballkanit Perëndimor, shërbimeve relevante të Komisionit Evropian, Rrjetit Evropian të Trajnimeve Gjyqësore dhe Këshillit për Bashkëpunim Rajonal.

Përfaqësuesit e institucioneve të trajnimit gjyqësor patën mundësinë që përmes debatit dhe diskutimeve të identifikojnë fushat e bashkëpunimit ndërinstytucional, si dhe identifikuan fushat konkrete ku ka nevojë për mbështetje për projekte të përbashkëta, nga e cila mund të përfitojnë institucionet trajnuese.

Pjesëmarrësit u dakorduan për hapat e ardhshëm duke përcaktuar edhe objektivat afatshkurtra dhe afatgjata të projekteve rajonale.

Në këtë takim u prezantuan aktivitetet dhe mundësitë e bashkëpunimit dhe përfuturit nga aktivitetet e realizuara nga Rrjeti Evropian i Trajnimeve Gjyqësore, mekanizëm ky i cili mund të mbështesë në disa forma institucionet e trajnimeve gjyqësore të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Po ashtu gjatë takimit u prezantuan edhe mekanizma e instrumente të ndryshme të Komisionit Evropian nga të cilat mund të përfitojnë institucionet trajnuese siç është TAIEX-i dhe projektet tjera të ngjashme.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**